



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/03-22540 dt. 20.05. 2022

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **30.05.2022** (E Hënë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal të dt. 27.04.2022
2. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike "Pastrimi"
3. Propozim Vendim për nisjen e proceduarve për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, (NPL) në Drenas .
4. Njoftim për Qarkoren buxhetore 2023/01, MFPT dhe Qarkorja Interne e Komunës së Drenasit.
5. Propozim Vendim për rialokim të mjeteve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
6. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
7. Raport lidhur me mbarëvajtjen e projektit "Komuna për të rinjtë" në Komunën e Drenasit
8. Të ndryshme.

Drenas, 20.05.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GILLOD			
GILLOD MUNICIPALITY			
Planuar	20.05	20.22	
Nj. Org	Numër	Shifra	Vlera
02	060/03	22540	

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 20.05.2022, si vijon:

Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca, për rendin e ditës, dhe i njoftoi anëtarët e KPF-së se kemi edhe katër pika shtesë:

1. Njoftim për qarkorën buxhetore 2023/01, MFPT dhe Qarkorja Interne e Komunës së Drenasit.
2. Propozim Vendim për rialokim të mjeteve në Drejtorinë e Shëndetsisë dhe Mirqenjes Sociale.
3. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
4. Raport lidhur me mbarëvajtjen e projektit "Komuna për të rinjtë në Komunën e Drenasit.

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime tjera për rendin e ditës kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës dhe votuan me: 06 vota (për), abstenim 01, kundër nuk pati.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 20.04.2022.

Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, dhe kaloi me vota unanime.

2. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike "Pastrimi"

Edhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend në mënyrë unanime nga gjithë anëtarët e KPF-se.

3. Propozim Vendim për nisjen e proceduarve për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, (NPL) në Drenas .

Pas diskutimeve edhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend në mënyrë unanime nga gjithë anëtarët e KPF-se.

4. Qarkorja buxhetore 2023/01, MFPT dhe Qarkorja Interne e Komunës së Drenasit.

Edhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend në mënyrë unanime nga gjithë anëtarët e KPF-se.

5. Propozim Vendim për rialokim të mjeteve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirqenjes Sociale.

Pas diskutimeve edhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend në mënyrë unanime nga gjithë anëtarët e KPF-se, dhe kërkuan material shtesë për këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen e kuvendit.

6. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa kërkuan material shtesë për mbledhjen e kuvendit. Kjo pikë e rendit të ditës u votua në këtë mënyrë: 4 vota (Për), 2 vota kundër, 1 abstenim.

7. Raport lidhur me mbarvajtjen e projektit "Komuna për të rinjtë në Komunën e Drenasit.

Pas diskutimeve edhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend.

8. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime.

Pasi nuk pati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11: 30



Kryesuesi i Kuvendit

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02-030-22362 dt. 20.05 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **27.04.2022**

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 28 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal të dt. 24.03.2022
2. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit 12 nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
3. Propozim-vendim për shpronësimin e njësive të ndërtesave-banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën kadastrale në Glllogoc.
4. Propozim-vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale nr.538/0 dhe 512/0 në zonën kadastrale në Nekoc.
5. Propozim-vendim për caktimin e lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit C nr. 97/86, të dt. 06.10.1988.
6. Propozim-vendim për bartjen e të hyrave vetanake.
7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02-020/04-8424, të dt. 23.02.2022.
8. Propozim-vendim për revidimin e Planit Komunal të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2022, i plotësuar.
9. Raporti Financiar Janar-Mars 2022.
10. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin të Rregullores për ndarjen e subvencioneve.
11. Njoftim për plotësimin me anëtar të KKS-së (Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi) dhe përfaqësuesin e Komitetit për Komunitete, plotësim të vendimit me nr. 12.030-65514 të dt. 23.12.2021, dhe vendimit me nr. 12.030/01-65508 të dt. 23.12.2021.
12. Të ndryshme.



Të mërkurën është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 13 pika për rend dite.

Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale dhe anëtarë të Kuvendit.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal, ku theksoj se u shtua edhe Propozimvendimi për rrënimin e objekteve të vjetra shkollore (ish-objekti i shkollës "Dëshmorët e Drenicës" Çikatovë e Vjetër dhe ish-objekti i shkollës "Abedin Bujupi" në Arllat) ishte një ndër pikat e shtuara në këtë mbledhje që mori përkrahjen e asamblistëve të Kuvendit Komunal të Drenasit

Egzona Tërdevci- pyeti: pse gjithë kjo urgjencë lidhur me rrënimin e këtyre dy shkollave?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- e kemi marrë një kërkesë nga Policia e Kosovës që objektet në fjalë janë të pa banuara, janë të rrezikuara për nxënës dhe kërkesa jonë që e kemi shtua në rend dite mos me prit në muajin tjetër është sepse edhe kompaninë që e kemi kontraktuar për rrenim i skadon kontrata në qershor për me e zënë këtë afat dhe për

me pas mundësi me realizua një qellim të një kërkesë të Policisë, ne e kemi formuar një komision për me dal me e verifiku, komisioni na ka rekomandua për këto dy objekte të cilat janë

objekte të pabanuara dhe që nuk zhvillohet asnjë aktivitet në ato objekte, udhëzimi administrativ i Ministrisë së Arsimit thotë çdo shkollë që ka më pak se 170 nxënës asnjë investim nuk kemi të drejte me e bë e aq më pak për shkollat ku nuk zhvillohet asnjë aktivitet, sepse kanë kaluar në objekt të ri nxënësit, kërkoj me e miratu këtë pikë të rendit të ditës me qellim që ta zbatojmë edhe rekomandimin e Policisë të Kosovës por edhe rekomandimin e komisionit adekuat i cili ka qenë dhe ka dhënë vlerësim për këtë pikë të rendit të ditës.

Arbër Halilaj, u ndërlihd më pikën 2,3 dhe 5 që kanë të bëjnë me pronat dhe nuk kanë kaluar si pika në KPF, kërkoj që ta kemi edhe si parim pikat të cilat kanë kontekste të ndryshme, padi apo peticione, kërkesa të ndryshme, paraprakisht të sqarohën ato qoftë me vendim gjyqësor qoftë në forma tjera e pastaj të vijnë në asamble, kërkoj që rendi i ditës të miratohet pa këto pika.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- pika e dytë nuk ka asnjë proces gjyqësor që duhet me u zhvillu, pra është pika ku kuvendi ka shpallë interes të përgjithshëm dhe ka kërkuar që objektet të cilat janë të banuara që i kanë pas 65 m² me mujt me i ndrru me pronat e komunës që janë në objektet e reja, Ministria e Financave e ka përcaktuar çmimin për m² të banesave të vjetra ose banoreve që janë aktual dhe e ka përcaktuar çmimin e banesave të reja të cilat i ka në përdorim komuna, komuna nuk ka të drejtë më i shit apo më i dhënë metra më shumë një pronari i cili e ka vlerën shumë më të ulët në karshi me vlerën që ia ka caktuar pronës tonë, prandaj ne po kërkojmë me e shfuqizua vendimin e kuvendit për me e bërë një vendim të ri që njerëzve me ju bërë zgjidhje sepse banoret aty as nuk po munden me ndërtua me e zhvillua jetën në ato banesa, kështu që mos me i mbajt peng, me vazhdu me procedurë që me ia lehtësua jetën atyre banoreve aty, nuk ka dhe asnjë proces gjyqësor nuk u zhvillua sa i përket pikës të dytë. Pika 3 shfuqizohet një vendim dhe merret një vendim tjetër, pika e 5 një pronar i cilit ja ka njoft shteti vendimin për me iu dhënë pronë, në vitet 88-ta, dhe një zyrtar komune pa asnjë procedurë ja ka caktua pronën ku me ia dhënë personit në fjalë, ne po kërkojmë vetëm me ia legalizua pronën, pra me marrë vendim sipas ligjit, komuna e ka për obligim me ia ofrua tri mundësi tri prona dhe njërën prej tyre me vendos kuvendi, cilën pronë ta vendosni në jemi në rregull, asnjë procedura gjyqësore nuk zhvillohet në këtë drejtim, i pakënaqur pronari mund me ndjek procedura. Një vendim i cili kurrë nuk ka qenë legjitim nuk mund të bëhet vendim i ligjshëm, një vendim kur nuk ka qenë i ligjshëm nuk mund të bëhet as sot pra i ligjshëm, prandaj ne po kërkojmë me e bërë vendimin e ligjshëm, kërkoj që t'i votoni pikat e rendit të ditës.

Filloreta Bujupi- a jeni konsultuar me administratoret e fshatit, duke pas parasysh se ata janë kundër rrënimt të kësaj shkolle, qysh e keni përfshi ju rrezikshmërinë në proces ate rrezikshmëri nuk e ka, administrata e fshatit kërkon që mos me u bë rrënimi i kësaj shkolle.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- nuk kemi kërkuar me e rrënu bibliotekën komisioni na ka sugjeruar me rrënu aneksin e objektit të vjetër, dhe ne nuk guxojmë me e rrezikua jetën e asnjë fëmije, asnjë qytetari tanë për aq kohë, sa që edhe Policia e Kosovës jep rekomandim që duhet të rrënohet. Pra ne jemi konsultuar edhe vet prindërit kanë kërkuar një gjë të tillë, e kemi formuar një komision, komisioni i cili na ka rekomandua.

Filloreta Bujupi- a jeni konsultuar individualisht me prindërit apo administratorin e fshatit që e përfshin krejt atë fshat, derisa administrata e fshatit na informon se jemi kundër rrënimt, dhe as nuk janë në dijeni administrata e fshatit për rrënimin e atij aneksi, se paku me e njoftu administratën e fshatit që ju keni marrë këtë vendim kaq shpejt.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kërkesat e prindërve janë më të mëdha se kush të shkruan ty, prandaj ne kërkojmë që pika e rendit të ditës me u votu, pastaj ne debat kemi mundësi me debat.

Azemine Bujupi-Gjoka, edhe ne si grup parlamentar i DD-së nuk do ta votojmë piken 2,3 dhe 5 për arsye se këto pika janë në kontekst gjyqësor dhe do t'i mbetet fjala e fundit gjykatës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, na thoni cila pik dhe cilin kontekst gjyqësor e kanë, ma sjellni me dokument, asnjë kontekst gjyqësor në këto pika nuk është, asnjë kontekst gjyqësor nuk zhvillohet për këto tri pika të rendit të ditës dhe po i diskutojmë.

Azemine Bujupi-Gjoka, pronari në fjalë Sahit Heta me vendim të gjykatës ju ka caktuar prona, atëherë pse ne me e diskutu vendimin e gjykatës dhe janë të pa negociushme vendimet që duhet të zbatohen.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, gjene ju vendimin që gjykata i ka thënë z.Heta me ia caktua pronën ku ja ka dhënë një zyrtar i komunës pa asnjë procedurë ligjore, ne duam që z.Heta me ia legalizu pronën sepse e ka me vendim të paligjshëm, gjykata ja ka njoft pronën si pronë, komuna nuk e ka zhvillu asnjë procedurë, zyrtari është proces gjyqësor për veprimet e veta.

Florentina Elezi, kërkoj nga kryesuesi që ta lexoj një shkresë e cila është dërguar në emër tendin nga personat e autorizuar nga familja Elezi, është bërë padi ndaj komunës për token ku behet fjalë për piken e dyte dhe tretë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne i kemi pranuar dje vetëm një dokument prej avokateve të autorizuar të familjes Elezi, asnjë shpronësim të pronës nuk jemi duke e bërë në këtë kuvend dhe as nuk po flasim për pronën në këto pika, prona në eksplorim është bërë në vitet e 60-70-ta i ka paguar apo jo nuk hyjmë në atë temë, kthimi i pronës as nuk ka ndodh as nuk ndodh, as nuk do të ndodh sepse kanë kaluar afatet për atë çështje, pra prona është e komunës, kërkesa për shpronësim apo jo e bëni ju në gjykatë dhe gjykata vendos. Prona aty është e komunës dhe do të jetë e komunës për aq kohë sa nuk ndryshohet me vendim të këtij kuvendi për dhënie apo jo në shfrytëzim, kurrë prona në emër të familjes Elezi nuk kthehet është kry ai proces, kane kaluar afatet, sot megjithatë nuk po diskutojmë për pronën por për objektet, në qoftë se familja Elezi ka interes e ka me të lehtë pasi ti heqim objektet që janë aty, pra ia lehtësojmë punën ne qoftë se ligji ia një të drejtën e pronës. Ajo procedurë nuk është në këto pika të rendit të ditës, kërkohet vetëm ndryshimi i asaj që u kane me ndërrim me e bërë me pagesë.

Florentina Elezi-Veliu, përderisa është në kontekst gjyqësor ju nuk keni të drejt me marrë asnjë vendim të paktën derisa gjykata nuk merr ndonjë vendim. Toka është në proces gjyqësor, dhe nuk guxojmë me marrë asnjë vendim derisa gjykata nuk e jep vendimin e saj.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, unë jam konsultuar me ligjin dhe e di saktë se çka thotë për pronat eksploruara, nuk kthehen më, prona është e komunës.

Hamit Haxhiu, kuvendi nuk guxon me marrë vendim pasi që është kjo është vendim i prerë i gjykatës, për piken e pestë, në bazë të drejtorit qysh ka thënë në Komitet për Politikë dhe Financa, nuk e di si ka ardh kjo pikë e rendit të ditës në kuvend derisa u votua kundër në Komitet për Politikë dhe Financa.

Bekim Lestrani, propozojmë vazhdu me seancën, për rendin e ditës përfaqësohen vetëm përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Albulena Saliuku, kërkoj me vazhdu me seancën, dhe me votua rendin e ditës, nuk mundemi me diskutua pa e votu rendin e ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- Komiteti për Politikë dhe Financa ashtë ai i cili rekomandon nuk e ka të drejtën me ndal si pikë për mos me shku në kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës me piken shtesë: Propozim-vendimi për rrënimin e objekteve të vjetra shkollore (ish-objekti i shkollës "Dëshmorët e Drenicës" Çikatovë e Vjetër dhe ish-objekti i shkollës "Abedin Bujupi" në Arllat) ishte një ndër pikat e shtuara në këtë mbledhje që mori përkrahjen e asamblistëve të Kuvendit Komunal të Drenasit
Prezent gjate votimit ishin 27 anetar: dhe votuan në këtë mënyre:
15 vota (për), kundër 12 vota, abstenim nuk pati. Kryesuesi me këtë konstatohet se u miratua rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- Komiteti për Politikë dhe Financa ashtë ai i cili rekomandon nuk e ka të drejtën me ndal si pikë për mos me shku në kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. **Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal të dt. 24.03.2022.**

Egzona Tërdevci, ka pas gabime logjike dhe drejtshkrimore në procesverbal, do të votoj kunder procesverbalit derisa të shkruhet drejt.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve që u dhanë kryesuesi konstatoi se procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 24.03.2022 ka kaluar me: 25 vota (Për), 2 vota (Kundër), 1 votë (abstenim). Prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: 2. **Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit 12 nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.**

Florentina Elezi- Unë edhe mandatin e kaluar kam qenë kundër edhe në qoftë që nuk kishin qenë këto kontekste gjyqësore, edhe nëse banoret-qytetaret ishin pajtu me u shpronësu edhe gjithë çka ne rregull me qene prape se prapë forma qysh na ka ardh qe është për një interes te përgjithshëm është e gabuar dhe unë nuk jam pajtuar as ne mandatin e kaluar, dhe do vazhdoj të mos pajtohem sepse ndërtimin e lartë-banesës nuk besoj që është në të mirën e të gjithë qytetarëve dhe që përfitojnë qytetarët por aty përfitojnë një grup i vogël i njerëzve për interesa të veta personale më shume, kështu që jam kundër.

Egzona Tërdevci- piken 2 dhe 3 do ta bëj të përbashkët meqë janë pika që lidhen, lidhur me piken 2 shfuqizimin e dt:30.10.2020 ne arsyetim thuhet qe këto prona nuk kanë mundur të këmbehen me banesat pronën komunale të ndërtuar në vitin 2014 për shkak të vlerës së vogël, kur keni dhënë një propozim të tillë po flasim për 2020 a keni qenë në dijeni për vlerën që kanë këto prona meqë keni llogaritë për ekuivalente, pronat e ndërtuara nga Komuna në vitin 2014 dhe a keni bërë ndonjë ankesë lidhur me vlerësimin e këtyre pronave nga zyra për vlerësimin e pronave të paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, duke pasur në konsideratë se këtë vendim të tyre e keni pranuar ju si organ shpronësues por edhe nëse nuk e keni pranuar vendim po besoj që jeni njoftuar për mes banoreve se ata nuk janë të kënaqur aspak me vlerësimin qe i është bërë nga kjo zyre, në situatën e këtij vlerësimi ku banoreve u janë vlerësuar tejet ulet për mos të thënë në mënyrë qesharake këto prona, a po mendoni që do të jetë një vlerësim ndryshe tani qe po e sillni prapë në Kuvend propozim për shpronësimin e këtyre pronave, në raste qe vlerësimi do të jetë i njëjte ose i përafërt këta

banorë nuk do të pranojnë sërish që t'i lëshojnë pronat apo objektet e tyre dhe kësisoj Komuna do të përballët me procese gjyqësore me ta nën supozimin që ata mund ta fitojnë gjyqin për shkak që prona private të rregullohet me ligj edhe është e shenjt, në këtë rast konsideroj që komuna do të mund të dilte e dëmtuar nga ky proces, po ashtu tek neni 4 i ligjit për shpronësimin e pronës pika 1.3 në raporte shpronësimin thuhet që mund të realizohet kur përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat që do të ndikohen negativisht nga shpronësimi, në arsyetimin tuaj thuhet që kjo po bëhet për realizimin e planit zhvillimor Komunal 2020-2028 ku parashihet ndërtimi i ndërtesave të larta hapësirë për rekreacion dhe gjelbërim, unë e kam lexu Planin Komunal por nuk është i detajuar a mundeni me na tregu sa do të jetë hapësira e gjelbër dhe për rekreacion që do të lirohet dhe kush do të përfitoj nga ndërtimi i këtyre ndërtesave të larta se kush po ndikohet negativisht veç e kemi parasysh, pra janë 11 Familje të cilave nuk po ju vlerësohet siç duhet prona e tyre, për fund po ju përcjell pyetjen e njërit nga pronaret e këtyre pronave me të cilin kemi biseduar para se të takohemi bashkë në seance, pse duhet Komuna të shpronësojë pronare privat për të ja dhënë pronën prapë një investitori privat kur kjo do të mund të realizohet me marrëveshje në mes tyre, Faleminderit.

Ramiz Lladrovci- Prona është e Komunës, banesat i shfrytëzojnë që janë aty të vendosur Kuvendi ka marr vendim për lirim e asaj pronës për shfrytëzim në interes të përgjithshëm kjo që po kërkojmë në sot e themë edhe sot votimit të pikave të rendit të ditës është që i hapim rrugë asaj pa kënaqësi të qytetarëve për çmimin ulët të cilin mund ta këtë vlerësuar organi përgjegjës që është në kuadër të Ministrisë së Financave të qeverisë së Republikës së Kosovës pra i hapim rrugë dhe në nuk kemi pasur mundësi asnjë ligj nuk ma lejon mi dhanë ma shumë metra dikujt ose me pak sepse e ka vlerësua Ministria edhe objektin që është i vjetër për dijeni të juve ata që i kanë blë këto objekte mund ta kenë një shumë tepër të vogël për shkak që ligji e thotë vitet e vjetërsisë së objektit e shumëzon e pjesëton e zbret çmimin prej 5-mijë euro sa ja kanë caktua nëse i ka pas 50 metra kur ka ardhë me pagë ka pagua 600-700 euro, dhe tash e ka vlerësua Ministria një shumë, unë nuk paragjykoj vlerësime të komisionit përgjegjës të Ministrisë së Financave, unë po i hap rrugë që këta banorë me i njëkë proceduar gjyqësorë dhe Gjykata me vendos nëse dikur jua ka bërë të padrejtë në Qeveri atje Gjykata i hap rrugë gjykatës për me jua vlerësua çmimin normal të vlerës që e ka, Gjykata i ka marr provat i ka regjistrua gjykata vendos për çmimin, plani zhvillimor është 8 vite votohet edhe për 8 vite është po i njëjti plan në qofte se nuk kanë diçka të parapare në qatë parcelë nuk kanë drejtë me votu se Liburn Aliu thotë që nuk e ka në plan zhvillimor edhe me hedh poshtë një vendit kur ta dërgojmë prej këtu për me bërë një vlerësim atje, pra këtë vendim që sot po e shfuqizojmë me bërë vendimin tjetër e kemi mundësinë me apeluar në gjykatë i hapim rrugë që mi lan zgjidhje qytetarëve tone me kërku një vlerë reale të pronës në të cilën janë duke banuar ata ajo është prone e Komunës që ligji jua ka leju me mbjell token po me blë objektin, Faleminderit.

Egzona Tërdevci- I nderuar zotëri Lladrovci prej pozicionit që jeni unë mendoj që ju duhet me qene prej pozicionit që jeni unë mendoj që ju duhet me qene pran qytetarëve jo kundër tyre për këtë arsye edhe të pyeta a ke provu me bërë ankese nuk besoj që është diçka e jashtëligjshëm nëse kisha bërë ankese kundër zyrës përkatëse për vlerësim në kuadër të Ministrisë së Financave, po thirrsh në planin zhvillimor Komunal, në planin zhvillimor në kuadër të transportit thuhet që edhe transporti publik me qene deri në ora 19.00 por në jemi të gjithë dëshmitar që nuk ka transport deri në atë kohë, për bënë që jo krejt senet i bëjmë në baze të planit zhvillimor veç ato që na pëlqejnë edhe na vënë me lehtë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, unë nuk kam të drejt me u ankua në ministri për çmimin që iu ka ofruar qytetareve ministria. Sa i përket transportit publik, transporti publik ka një orar të cilët janë të detyruar operatorët me e mbajte, dhe ata që nuk e mbajnë orarin e kontrollon inspeksioni.

Arbër Halilaj, u ndërlidh me pikën e dytë dhe pikën e tretë sepse kanë të bëjnë me te njëjtit objekt banesor dhe për arsye se neni 19 i rregullores të punës së kuvendit nuk e lejon me marrë pjesë në votime dhe do ta liroj seancën.

Jemi duke fol për shfuqizim të një vendimi që e ka marrë asambleja më herët në vitin 2020, natyrisht që një institucion që merr vendime ka të drejtë edhe t'i shfuqizojë ato, mirëpo neni 56 i ligjit për procedurën e përgjithshme administrative thotë: një akt administrativ i ligjshëm mund të anulohet vetëm nëse anulimi është dobiprurës për të gjitha palët që në këtë rast për arsye të ankesave të qytetareve nuk është dobiprurës për gjitha palët.

Pastaj Arbër Halilaj e lexoj peticionin e pronareve lidhur me këmbimin (shpronësimin) e njërive banesore në Qendër të Drenasit. Me numër të protokollit: 01-070-17043 të dt. 20.04.2022. I bashkangjitur është edhe peticioni i lexuar nga Arbër Halilaj.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne kemi diskutuar edhe për këtë peticion, peticioni nuk vlen, kërkesa është diçka tjetër, vendimet e kuvendit nuk janë akte administrative, e mos i ngatërro ligjin me procedura administrative, pra vendimet e kuvendit janë akte normative e jo akte administrative. Prona ka qenë e komunës ju keni qenë banor me qira, ju pronar jeni bërë vetëm atëherë kur ligji ia ka leju me e ble banesë, ju nuk jeni pronar të tokës jeni pronar të banesave. Ne ju kemi thirr ne debat për këtë çështje këtu të gjithëve dikush është pajtuar për ndërrim e dikush për shpronësim, dhe ne kemi pranuar me qenë shpronësim, pra çmimi i caktuar nga ministria, komisioni përkatës i Ministrisë së Financave me atë që ne e kemi menduar është shumë i lartë, për këtë arsye ne po provojmë në këtë rast me i hap rrugë procedurave gjyqësore me e ndjek të drejtën çdo njeri për vlerësimin real në gjykatë, nëse ne nuk e kalojmë këtë procedure nuk mundeni me e bërë asnjë gjë. Prona ka qenë e komunës ju keni qenë banor me qira, ju pronar jeni bërë vetëm atëherë kur ligji ia ka leju me e ble banesë, ju nuk jeni pronar të tokës jeni pronar të banesave. Kërkoj me e votu këtë pikë të rendit të ditës për arsye që me pas mundësi me i zhvillua procedurat me shpejt që edhe gjykata me vendos në favor të asaj që është e drejt.

Mehedin Salihu, cili është interesi publik, ku mbeten banoret derisa të realizohet procesi i banimit a keni paraparë ndonjë program për rehabilitimin e tyre, edhe pse janë gjithë ato ankesa nga qytetaret e saj zone duke u bazuar ne peticion!

Azemine Bujupi-Gjoka, Ne po e potencojmë se jemi kundër pikës së dytë Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit 12 nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe për shfuqizimin e vendimit të shpronësimit të pronave e pronareve të zonës qendra në Drenas, pasi që pronaret e këtyre pronave nuk janë të pajtimit dhe për arsye të vlerësimit jo adekuat për arsye të vlerësimit jo të barabartë për m² të njëjtë, ne mendojmë se duhet krijuar një komision adekuat për verifikim të gjendjes reale të këtyre njësive banesore duke i kompensuar ato me njësi banesore për m² të njëjtë pasi që e drejta e pronës është e garantuar me ligj, madje këto prona sipas pronareve janë në kontekst gjyqësor dhe nuk mund të zhvillohen procedura tjera nga Kuvendi Komunal deri ne verdiktin e fundit të gjykatës, i njeri rast është me ujësjellësin pasi që ne ende jemi duke prit me u realizua ai projekt për 22 fshatra edhe për arsye të kontekstit gjyqësor nuk mund nuk po realizohet ky projekt. Cili është plani zhvillimor në këto prona për interes publik derisa po ju merret prona qytetareve dhe po

ju jepet investitorëve privat për qëllime banesorë por jo edhe për interes publik ashtu siq e potenconi ju.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ky vendim është për ndërrim të pronës e që qeveria e ka vlerësuar shumë ulët pronën e pronareve aktuale me pronën e komunës, prona nuk është në proces gjyqësor, prona është e komunës, objektet janë të pronareve të cilët i kanë në proces të shpronësimit dhe në proces të ndërrimit të objekteve, pra ndërrimin e objekteve po e kthejmë në çështje të shpronësimit për me pas mundësi me ia dhënë me shpejt zgjidhjen e të drejtës të pronës te objektit jo të tokës. Plani zhvillimor, as nuk kemi vendos, as nuk e dimë kush ka me e marrë atë vend, ju keni me qenë atë që keni me ja dhënë atë vend atij që do të ndërtoj aty çka do qoftë ai projekt pra, pra ne e propozojmë një komision prej kuvendi dhe ekzekutivi dhe vendosin në bazë të kushteve kritereve, dhe ju keni me vendos për atë çështje. Me pronë komunale vendosni ju.

Azemine Bujupi-Gjoka, pse nuk po i kompensoni me njësi banesore të njëjta qytetaret derisa ata nuk janë të pajtimit dhe ne nuk do ta votojmë.

Egzona Tërdevci, po deklarohej emër te grupit e këto dy pika ne nuk do t'i votojmë, e lëshojmë seancën kthehem prapë për pika tjera.

Pasi nuk pati diskutime tjera, kryesuesi hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, prezent gjatë votimi ishin 22 anëtar, 15 anëtar votuan (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati. Te tjerët anëtar të kuvendit e lëshuan sallën.

Pas këtyre diskutimeve dhe votimit të pikës së dytë të rendit të ditës, seanca ndërkrehet për një orë pauzë.

Pas pauze seanca vazhdoj duke u rikthye serish tek pika e dytë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, kërkoj që pika e dytë e rendit të ditës të hedhet edhe një herë në votim 2. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit 12 nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit. Prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, për votuan 13 anëtar, kundër 1 votë, abstenim 2 vota.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tretë rendit të ditës: **3. Propozim-vendim për shpronësimin e njësive të ndërtesave-banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën kadastrale në Glllogoc.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, për votuan 15 anëtar, kundër 1, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tretë rendit të ditës: **4. Propozim-vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale nr.538/0 dhe 512/0 në zonën kadastrale në Nekoc.**

Drejtori për Gjeodezi dhe Kadaster Ruzhdi Lestrani, para jush e keni propozim këmbimin për qellim të rregullimit të infrastrukturës rrugore në Nekoc me qellim të realizimit të rrugës ne Nekoc e cila ka filluar dhe ka mbet ne gjysme për arsyeje se ka mungesë të pjesës se rrugës dhe për qellim që mos me i prek pronat private me kërkesën nr. 07/14-365 te dt. 01.04.2022 me të cilën është drejtuar Fatmir Uka nga Nekoci zyrës të kryetarit dhe Drejtorisë për Gjeodezi të ju mundësohet këmbimi i pjesëve mes komunës dhe asaj private konkretisht parcelës 512 e

cila është pronë shoqerore dhe parcelës 538 e cila është e cila është pronë private me pronar Fatmir Ukën. Qëllimi i këtij këmbimi është që të behet mundësimi i rregullimit të rrugës konkrete në këtë segment rrugor.

Beqir Kiqina, shpronësimi për çka do të përdoret toka e cila shpronësohet nga pronë publike në pronë private apo anasjelltas?

Drejtori për Gjeodezi dhe Kadaster Ruzhdi Lestrani, kemi të bëjmë me këmbim të njësive, këmbimi behet në pronë komunale në pronën private me qëllim të rregullimit të rrugës.

Pas diskutimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës. Prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar, **Për 24 vota, kundër 1 votë, abstenim nuk pati.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e pestë rendit të ditës: **5. Propozim-vendim për caktimin e lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit C nr. 97/86, të dt. 06.10.1988.**

Ruzhdi Lestrani - Përshëndetje te gjithëve, qëllimi i këtij propozim vendimi për caktimin e lokacionit për zbatimin e aktgjykimit 97-86 te datës 06.10.1988, duke pasur parasysh që ligji e kërkon një procedurë te tille ne si institucion kem i formuar një komision i cili ka dal edhe ka be 3 propozime për 3 lokacione ne te njëjtën zone katastrale ashtu siç kërkohet me ligj propozimet janë këto:

Propozimi 1 te gjitha janë zona katastrale ne Qikatove te Re i pari është ne pjesën e ngastrës me sipërfaqe 19 Ari me kulture klase 2

Propozimi 2 është zonën kadastrale ne Qikatove te Re ne pjesën e ngastrës katastrale 826, pjesa e propozuar e sipërfaqes është 19 Ari me kulture te klasit te pare.

Propozimi i 3 ne zonën katastrale ne Qikatove te Re ne pjesën e ngastrës 326 për 4 pjesa e propozuar është 19 Ari e klasit te pare

Komuna e Drenasit me qëllim te zbatimit te aktgjykimit 97-86 te datës 06.10.1988 i cili i propozon Kuvendit te Komunës se Drenasit caktimin e lokacionit për zbatimin e aktgjykimit te larte cekur ku i është njohur e drejta e pronës Istref Heta nga Drenasi me sipërfaqe 19 Ari ne zonën kadastrale ne Qikatove te Re kjo ka ardhur për arsye pasi që aktgjykimi te larte cekur i është njohur e drejta e pronës se Istref Heta ne parcelën 118 ne zonën kadastrale, Qikatove e Re e cila parcele gjate procedurave te komasacionit është futur ne masën komosative dhe për këtë arsye është e pamundur te zbatohet aktgjykimi 97-87 i datës 06.10.1988, per këtë qëllim ne si institucion për te ja njohur te drejtën e vete legjitimit, qytetarit te cilit e ka njohur Gjykata ne si institucion me qëllim te realizimit te drejte te pronës zbatim te gjykimit kemi caktuar ashtu siç e parasheh edhe ligji komision për dhënien e propozimeve për caktimin e akt gjykimit njëkohësisht vendosjen e ligjshmërisë lidhur me këtë qeshje

Komuna e Drenasit ne rastin konkret ka marre te gjitha procedurat e nevojshme duke dërguar për aprovim këtë propozim vendim ne Kuvendin e Komunës se Drenasit si organi i vetmi i cilin menagjon me pronat komunale, krejte qëllimi i këtij aktvendimi është se që pjesën te cilën e kane njohur Gjykata me aktgjykimin e larte cekur ne si Komune nuk mundemi me e regjistru përmes ligjit te kadastrit për arsye se ajo parcele me atë numër me numrin 118 është ne mase komosative e cila ju ka nda dikujt tjetër, meqenëse ne te kishim pasur mundësi me vendos ajo parcele me qene ne qene ne sistem mos me qene komasacion ne se kishim prur ne Kuvend e kishim regjistru sipas detyrës zyrtare ashtu siç e parasheh ligji mbi kadastrin ne mungesë te kësaj qe mos te dëmtohet pala dhe ti njihet e drejta atij ne i kemi bere këto

propozime ashtu qysh e parasheh edhe ligjet, dokumente shtese komiteti ka kërkuar ato ne ia kemi dërguar, fleta poseduese e vitit 24.11.1989 në të cilën në atë kohë ju ka regjistruar prona e Istref Bilal Hetës në Glllogoc me sipërfaqe 19 ari, kjo pronë pastaj është fut në masën komosative dhe iu ka dhënë në lokacion të ndryshëm pronarit jo aty ku i ke pas pronat me iu njoft e drejta e tyre pronësore por ia kanë mbledh pronat me një vend të caktuar ashtu siç e parasheh ligji i komasacionit dhe ligji për te drejtën pronësore me qëllim të shfrytëzimit sa ma të mirë të tyre, e kanë bërë grumbullim e parcelave te vogla me një parcelë te madhe.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, në vitin 2014 një zyrtar i komunës e ka përcaktuar ku me marrë pronën personi në fjalë, ne e kemi bërë komisionin dhe komisioni i ka përcaktua tri parcela, ju jeni ata qe vendosni për cilën parcelë ose vendosni kundër këtij propozim vendimi.

Hamit Haxhiu, a është vendim i prerë i gjykatës?

Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër Ruzhdi Lestrani, e ke fjalën për vendimin e 88-es dhe konfirmimin nga gjykata supreme që është bërë është i formës se prerë, nëse e ki fjalën për këtë që e kanë bërë zyrtaret nuk ka vendim të kuvendit për bartjen dhe njohjen e te drejtës që iu ka bërë palës në atë kohë për atë arsyeje po e sjellim në kuvend s ashtu e thotë ligji.

Zeqir Hasi, sa i përket pikës së pestë unë para vetes kam një vendim të komunës të vitit 2014 që ju po e quani të jashtëligjshëm do ishte shumë më mirë ta bëjmë të ligjshëm se sa me e ndrru atë parcele, nuk e dimë arsyetimin pse duhet me ju ndrru parcela pronarit kur pronari është që dhjetë vite shfrytëzues. Vendimet e pa ligjshme që ia ka dhënë pronën një zyrtar nuk mundemi me i bërë të ligjshme ne.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nuk ka vendim të komunës, ne po kontestojmë vendimet e zyrtareve që i kane marrë ne kundërshtim me ligjin, zyrtari ia ka dhënë pronën kundërligjshëm nuk ka qenë asnjëherë prona e atij ku ja ka dhënë zyrtari, kur ta voton kuvendi pronën ku me ia dhënë pas asaj që e ka përcaktuar komisioni, komisioni propozon kuvendi voton apo jo, komisioni i ka bërë tri propozime sipas ligjit e keni obligim me e votua njërin propozim ose me votua kundër tri propozim vendimeve.

Bekim Lestrani, ne kemi një vendim të gjykatës i cili e propozon komunën që qe me e bërë një vendim, pronën që e ka pronari ja ka caktuar nje zyrtar i cili është i paligjshëm dhe ne po ju përmbahemi vendimit të gjykatës.

Filloreta Bujupi, kryetari e tha që ka njëvendim për shkelje, a mundemi me na prezantu atë vendim dhe ata zyrtar që i kane bërë këto shkelje me na informu neve të paktën qfar masa keni marrë?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, këtë vendim e ka marrë një zyrtar ne vitin 2014 në pajtim me pronarin dhe ia ka caktuar pronën në emër tij pa e ndjek asnjë procedurë që duhet me u ndjek, prandaj ne po kërkojmë procedurat me i ndjek, si rezultat e kësaj zyrtari në fjalë dhe zyrtare te tjerë që kane bërë shkelje janë në procese gjyqësore dhe neve agjensioni na ka kërkuar me i zbatua vendimet dhe ne i kemi sjelle propozimet te ju.

Egzona Tërdevci, kërkoj sqarim për votimin psh tri propozimet dhe asnjëra se mbërrin shumicën, asnjëra nuk kalon.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, keni me e votu njërën nga parcelat, votoni me shumice a me votu parcelën e parë, të dytën apo të tretën, vetëm një e propozojmë, mandej votoni për atë parcele apo kundër krejt. Cila i mbërrin votat ajo realizohet.

Hamit Haxhiu, se pari votohet pika me pas kur të votohet pika vazhdojmë me tri propozimet. Nëse kundërshtohet pika t'i nuk mundesh me hi me propozime.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, grupet parlamentare le te deklarohen me cilin propozim dojnë me shku. Kërkoj nga Grupet kuvendare me i bëre propozimet.

Egzona Tërdevci, në emër të grupit LVV, ne propozojmë me u votu si pikë në tërësi. Ne kemi biseduar me z.Istref Heta dhe z.Heta është kundër tri propozimeve, kur ne votojmë kundër pikës atëherë bien komplet propozimi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës: Propozim-vendim për caktimin e lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit C nr. 97/86, të dt. 06.10.1988me propozimin e parë prezent gjatë votimit janë 27 anëtar, 14 vota Për, kundër 13 vota kundër abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim-vendim për bartjen e të hyrave vetanake.**

Pasi qe nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim pikën Propozim-vendim për bartjen e të hyrave vetanake. Prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, për votuan 16 anëtar, abstenim nuk pati, kundër nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës. **7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02-020/04-8424, të dt. 23.02.2022.**

Pasi qe nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim pikën e shtatë **7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02-020/04-8424, të dt. 23.02.2022.** Prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, për votuan 16 anëtar, abstenim nuk pati, kundër nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës. **8. Propozim-vendim për revidimin e Planit Komunal të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2022, i plotësuar.**

Pasi qe nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim pikën e tetë të rendit të ditës, Prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, për votuan 16 anëtar, abstenim nuk pati, kundër nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës. **9. Raporti Financiar Janar-Mars 2022.**

Meqë raporti nuk votohet, diskutime nuk pati kaloj tek pika tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës. **10. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin të Rregullores për ndarjen e subvencioneve.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës, Prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, për votuan 16 anëtar, abstenim nuk pati, kundër nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës. **11. Njoftim për plotësimin me anëtar të KKS-së (Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi) dhe përfaqësuesin e Komitetit për Komunitete, plotësim të vendimit me nr. 12.030-65514 të dt. 23.12.2021, dhe vendimit me nr. 12.030/01-65508 të dt. 23.12.2021.**

Kryesuesi i njoftoi rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës. **12. Propozim-vendimi për rrënimin e objekteve të vjetra shkollore (ish-objekti i shkollës "Dëshmorët e Drenicës" Çikatovë e Vjetër dhe ish-objekti i shkollës "Abedin Bujupi" në Arllat.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, për votuan 16 anëtar, abstenim nuk pati, kundër nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës. **13. Të ndryshme.**

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 13:50 min .

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 27.04.2022 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Januar	20	04	2022
Nr. Org	1	mër	Vlera
01.070-17043			

Për: Kryetarin e Komunës
z. Ramiz Lladrovci

Drenas, më 14.04.2022

Cc: Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Subjekti: PETITION me kërkesat e pronarëve lidhur me këmbimin (shpronësimin) e njësive banesore në Qendër të Drenasit.

I nderuar Kryetar i Komunës,

Ne banorët e poshtë-nënshkruar të zonës Qendra-Drenas jemi thellësisht të shqetësuar dhe të irrituar nga mënyra se si po vijon procedura e vlerësimit të pronave tona-njësive banesore, që janë në procedurë vlerësimi për këmbimin - shpronësimin e inicuar nga Ju si Organ Shpronësues, ndërlidhur me Vendimin e KK Drenas 12.Nr.462/01-47368 të datës 30.10.2020, për realizimin e projektit të Planit Urbanistik, Hapësinor dhe Zhvillimor Komunal 2020-2028.

Duke u thirrur në interesin publik, siç është Plani Urbanistik, Hapësinor dhe Zhvillimor Komunal 2020-2028, neve po na mirret e drejta e pronës që e kemi poseduar kush më gjatë e kush më shkurt qe 30-50 vite. E drejta e pronës priv ate është një nga të drejtat themelore të njeriut, si kategori bazike ekonomike-juridike. Liria e Prones private është një e drejtë kushtetuese e cila garanton paprekshmërinë e pronës private nga ndërhyrjet e pajustificuara të organeve shtetërore ose palëve të treta.

Në Republikën e Kosovës e drejta e pronësisë garantohet nga Neni 46 i Kushtetues dhe nga një mori aktesh të tjera ligjore ose nënligjore.

Neni 46 [Mbrotja e Pronës] e përcakton se:

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrashjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

Formulimi i parashikuar në Nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e pranon në mënyrë pohuese se e drejta e pronësisë mund të kufizohet ose prona të ekspropriohehet përmes procedurave të shpronësimit, veprim ky të cilin askush nga ne nuk e konteston, si një e drejtë e organeve shtetërore qendrore ose lokale në pajtim me interesin publik. Neni 46, pika 3 e Kushtetutës përcakton se *"Ligji mund të autorizojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike dhe duhet pasuar me sigurimin e kompensimit TË MENJËHERSHËM dhe ADEKUAT për ato prona"*.

Në këtë pikë thuhet se askush nuk do të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, pra shpronësimi me qëllim të këmbimit bëhet me Ligj dhe Udhëzime të veçanta përkundrejt një shpërblimi të drejtë për pronën, e bile parasheh edhe respektimin e kësaj të drejte përmes gjykatës, në rastin më të keq.

Sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronave të paluajtshme, Organi Shpronësues (në rastin tonë Kryetari i Komunës) është i autorizuar të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm pas përmbushjes së të gjitha kushteve në vijim:

- 1.1. shpronësimi bëhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik brenda kompetencave të tij të përcaktuara në paragrafët 2 ose 3 të këtij neni;
- 1.2. qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e Shpronësimit;
- 1.3. përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat të cilat do të ndikohen negativisht nga Shpronësimi;
- 1.4. prona e paluajtshme e cila është objekt i shpronësimit nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues; dhe
- 1.5. Organi Shpronësues i ka përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

Kufizimi i të drejtës së pronësisë duhet të përmbushë kërkesën e të qenit në përputhje me legjislacionin, Kushtetutën dhe udhëzimet tjera. Shteti, në këtë rast KK Drenas, mund të na e kufizojë ose heq të drejtën e pronës, gjë që ne nuk po e kundërshtojmë në asnjë mënyrë, por ky veprim duhet ta ketë burimin në legjislacionin tonë dhe duhet të jetë i shoqëruar me informim të qartë, duhet të ketë karakteristika dhe masa adekuate mbrojtëse procedurale, me qëllim mbrojtjen e neve pronarëve nga arbitrariteti, mbrojtjen nga moskompensimi adekuat dhe nga diskriminimi, sic e cekë pika 1.4 më sipër.

Pikërisht tek vlerësimi i pronës nga Zyra për Vlerësimin e Patundshmërive në kuadër të Ministrisë së Financave qëndron i gjithë problemi, meqë është bërë në mënyrë diskriminuese dhe të njëanshme.

Së pari, ne nuk e kemi të qartë as faktin pse vlerësohet një njësi banesore ku banon një familje, kur dihet sipërfaqja e saj dhe ajo pronë është legale. Ajo do të duhej shpronësuar duke u kompensuar SË PAKU me një njësi banesore të sipërfaqes së njejtë në objektin ku synohet të ndërtohet ose në banesat ekzistuese që janë pronë komunale, në të njëjtin lokacion-lagje. Bile, sipërfaqja e banesave prej 61m2 është Neto (në sistemin kur janë ndërtuar) ndërsa tani, me metodën e tanishme të matjes dhe shitjes së banesave-ndërtime të reja, ajo është proporcionale me rreth 75m2 bruto (pra, me sistemi i tanishëm i kalkulimit të sipërfaqeve të banesave për shitje, ku matet deri në gjysmën e murit ndarës me banesën fqinje).

E dyta, fakte tjera që nuk po mirren parasysh dhe që na dëmtojnë neve si banorë janë:

- Këto banesa kanë qenë të djegura dhe secili kemi investuar 20.000-40.000 DM (marka gjermane) për t'i kthyer në banesa të banueshme për familje pas luftës, pothuajse pa ndihmën e askujt. Ne këtu humbim jo vetëm të drejtën e pronës, por edhe investimet e bëra për t'i kthyer nga banesat e djegura në njësi të rregullta banimi. Në vende demokratike, do të kompenzohej edhe dëmi para shpronësimit, që dmth.: investimet tona që i kemi bërë për të qenë banesat në gjendje të banueshme pas luftës!
- Banesat kanë 3.5-4 ari oborr që e kemi shfrytëzuar, ku shumë prej nesh kemi mbjellë edhe pemë e gjelbërim, gjë të cilat nuk parashihen fare në kompensim të dëmit nga shpronësimi
- Secila banesë ka pasë depo funksionale, me së paku 5m2 sipërfaqe.
- Nga rritja e familjeve jemi detyruar të investojmë në anekse (nënkulme) të cilat ose janë në procedurë legalizimi, ose nuk na është mundur t'i legalizojmë, ndërsa për të njejtat

- gjithmonë kemi paguar tatim në pronë, gjë që është një anomali e llojit të vet (pagesa e tatimit për një aneks të konsideruar jolegal).
- Neve nuk kanë pse na kompenzohen muret ose çatitë, pavarësisht gjendjes në të cilën janë. Neve po na merret e drejta e pronës në sipërfaqen e caktuar të banimit, që duhet të na kompenzohet me sipërfaqe banimi, nëse duam shpronësim me kompenzim adekuat dhe të drejtë.
 - Banesat kanë mure të jashtme 50 cm. dhe përkundër djegies dhe vitit të ndërtimit, anekset e shtuara, pllakat e katit etj. nuk kanë pasur nevojë për kurrfarë përforsimi të veçantë gjatë rindërtimit. Kjo tregon që shumëzimi me koeficient 0.7 duke i futur në Klasën e katërt është bërë vetëm për të zhvlerësuar sa më shumë pronën dhe për ta kompenzuar me shuma qesharake të hollash, meqë as viti i ndërtimit nuk duket të jetë i saktë (deri më 1959).
 - Diskriminimi është evident edhe kur njësitë tona banesore në gjendje dhe pozita të ndryshme në lagje, vlerësohen me dallime të mëdha në vlera deri në 3-4 fish njëra nga tjetra. Synimi kryesor i Organit Shpronësues dhe Komunës duhet të jetë mosdiskriminimi dhe mosdëmtimi i neve pronarëve, që veç jemi të dëmtuar me vet faktin e heqjes së pronësisë në këtë mënyrë.
 - Çmimet e tregut në lokacionin ekzistues ose metoda e krahasimit me lokacione të ngjashme nuk është marrë fare parasysh dhe ka ardhë deri te një vlerësim qesharak, ku një njësi banesore 61m² Neto vlerësohet sa 20m² e çmimit të tanishëm të tregut. Sipas Udhëzimit Administrativ MF-NR.02/2015 për metodat e vlerësimit apo përlogaritjes së shumës së kompenzimit për prona të paluajtshme që shpronësohen dhe dëmët lidhur me shpronësimin, Neni 12, pika 1, ceken 10 kritere për përcaktimin e vlerës së ndërtesës (banesës) që vlerësohet, ndërsa në rastin tonë përmendet vetëm viti i ndërtimit dhe amortizimi, duke anashkaluar kriteret tjera favorizuese, gjë që ndikon direkt në nënvlerësimin e njësitë tona banesore. Po flasim për hapësirë në Qendren 0.0. të Drenasit !!!
 - Neni 13 i të njejtit Udhëzim thekson pjesët aksesore dhe frutat, që në vlerësimin e pronave tona nuk janë marrë parasysh,
 - Edhe nëse kanë munguar treguesit e shitblerjeve në lokacion, që është qendra 0.0 e Drenasit, Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme është dashur të marrë informata shtesë nga institucione e zyrtarë tjerë, siç e përcakton Neni 16 i Udhëzimit,
 - Në të njejtin lokacion-lagje janë shkëmbyer banesa të fqinjëve tanë (të djegura e rrënuara), ku kompenzimi është bërë duke iu dhënë hapësirë banesore e re, në të njejtin vend ku kanë jetuar më parë. Kompensimi në forma tjera duke e ulur ndjeshëm ose për katër-pesëfish nga çmimi i tregut vlerën e pronave tona, është diskriminim i hapur dhe shkelje e të drejtave tona elementare të pronës dhe banimit.
 - Duhet të theksohet fakti se prona jonë private, me këtë mënyrë të shpronësimit, këmbëhet, me pronën në shfrytëzim për 99 vite.
 - Nuk janë mbajtur në pajtim me ligjin dhe afatet dëgjimet publike me pronarët, nuk dijmë afate të realizimit të shpronësimit, nuk është bërë informimi për punët përgatitore etj.

I gjithë procesi i heqjes së përhershme të së drejtës së pronësisë një individ mund të realizohet vetëm kur arsyetohet nga një synim i ligjshëm e në interesin e përgjithshëm (publik), siç u cek më lart. Autoritetet lokale janë në pozitë më të mirë për të përcaktuar atë se çfarë është interes publik derisa gjykimi i tyre është dukshëm i pabazuar dhe çon në arbitraritet, sepse ndërtimi i banesave për shitje sipas Planit Urbanistik mund të jetë interes publik dhe i përfitimit nga ana e Komunës së Drenasit bashkë me Investitorin potencial, por nuk mund të bëhet duke vepruar në dëm të pronarëve aktual, siç po synohet të bëhet përmes devalvimit të vlerës së pronave tona-banesave.

Komuna e Drenasit duhet të vendosë një raport të drejtë ndërmjet interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe të drejtave themelore të individit. Nuk do të ekzistojë një raport i drejtë në rast se pronari i banesës vihet para aktit të kryer të dëmtimit financiar me këtë këmbim prone-(shpronësim).

E drejta e gëzimit të pronës private është e njohur dhe e garantuar nga Kushtetuta dhe ligji, siç e cekëm në fillim, ndërsa në themel të çdo procedure shpronësimi qëndron mbrojtja e kësaj të

drejte. Kjo garanci kushtetuese u lejon pronarëve të gëzojnë të drejtën e pronësisë për pronat e tyre dhe në të njëjtën kohë mbron pronarin privat nga çdo veprim arbitrar shtetëror. Shteti nuk mund të përdorë pushtetin e tij për të marrë pronën e personave privat, përveçse në rastet e parashikuara në Kushtetutë e ligje, siç është shpronësimi për interes publik dhe vetëm përkundrejt një SHPËRBLIMI TË DREJTË, REAL dhe SIPAS KUSHTEVE TË TREGUT për pasurinë që këmbëhet (shpronësohet) për qëllime të interesit publik.

Shpërblimi i drejtë dhe mosdiskriminimi është thelbi i petitionit tonë dhe kërkesa bazë ndaj Organit Shpronësues dhe Komunës së Drenasit. Mjaft kemi vuajtur në pushtetë të kaluara që kanë bërë çfarë kanë dashur me pronat e shqiptarëve, prandaj duam të parandalojmë dhe të pamundësojmë përsërtitjen e këtyre situatave tani, kur kemi shtetin tonë demokratik. Baza e shpronësimit për interes publik duhet të jetë që edhe komuniteti, por edhe vet pronari i shpronësuar të kenë përfitime në rritjen e vlerës së pronës së tyre dhe kualitetit të jetës.

Mbesim me shpresë që do t'i mbron pronat tona nga këmbimi (shpronësimi) i padrejtë dhe do të përdorni autoritetin tuaj si Organ Shpronësues që krejt procesi të shkojë në mënyrë korrekte dhe në pajtim me ligjet në fuqi.

Prona është e shenjtë dhe nuk do ta japim për kompenzime qesharake !

Pasojnë nënshkrimet e pronarëve:

Emri dhe mbiemri Nr.personal Nënshkrimi

- | | | |
|--------------------|------------|--------------|
| 1. FADIL HAXHIU | 1010430166 | <i>Fadil</i> |
| 2. Xhyla Halilaj | 1014690626 | XHYLA |
| 3. Mysli Morina | 1005714326 | Mysli |
| 4. Atsim Gashi | 1500270892 | Atsim |
| 5. JETON HOXHA | 1010471440 | Hoxha |
| 6. APRIM HYSENAJ | 1015708715 | Aprim |
| 7. Shkumbin Morina | 1005714881 | Shkumbin |
| 8. MURTEZ ZOGU | 1015707522 | MZogu |
| 9. Ruzhdi Hoxha | 101344634 | R. Hoxha |
| 10. | | |
| 11. | | |
| 12. | | |
| 13. | | |
| 14. | | |
| 15. | | |

DORËZOI:

Arber Halilaj
Mauriz
ID nr.: 1014693722



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Glllogoc)

Zyra e Kryetarit



01 Nr. 020/04 - 20867 Dt. 12.05.2022

Në bazë të nenit 5, pika 5.2, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike me nr.03/L-087 dhe nenit 72, pika 72.2 nënpika (k) e Statutit të Komunës së Glllogocit, i dt. 16.09.2008, Kryetari i Komunës së Glllogocit, nxjerr këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike “PASTRIMI”

Neni I

Me këtë Propozim-Vendim formohet **Komisioni Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike “PASTRIMI” i komunës së Drenasit**

Neni II

Në kuadër të këtij Komisioni Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen publike, në bazë të nenit 5, pika 5.2, në përbërje duhet të jenë:

- a. Një anëtar i emëruar nga Kryetari i komunës dhe
- b. Dy anëtarë të emëruar nga Kuvendi i komunës

Neni III

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit Komunal të Aksionareve në bazë të nenit 7, pikat (7.1-7.3) janë si me poshtë:

1. Komisioni Komunal i Aksionareve ka të drejtë të veproj në emër të komunës në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, se si do të ushtroj të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar
2. Aksionari(ët) e një NP do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së në fjalë,
3. Nëse performanca e NP-së devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit të miratuar nga Bordi i Drejtorëve për vitin përkatës financiar, Aksionari(ët) do të kërkojnë nga Bordi i Drejtorëve që të përgatisë dhe t'u dorëzojë atyre një raport i cili i shpjegon arsyet për performancën e dobët, dhe Aksionari(ët) do të marrin të gjitha masat e duhura korrigjuese.
4. Nëse një NP dështon në arritjen e caceve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, personi(at) përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të aksionarit është i detyruar që të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e Bordit të Drejtorëve ose shumicës së anëtarëve të tij. Një veprim i këtillë mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës nga Bordi ose anëtarët përkatës të bordit, përveç nëse Aksionari(ët) konstatojnë se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Personat përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të Aksionarit do t'ia raportojnë çdo vendim të marrë në bazë të këtij Neni 7.3, dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi: (i) Kuvendit, për NP-të Qendrore, ose (ii) Kuvendit përkatës Komunal, për NP-të Lokale.

Neni IV

Grupi punues është në këtë përbërje:

1. Lumnije Krapo, e caktuar nga Kryetari I komunës
2. _____ Kuvendi I komunës,
3. _____ Kuvendi I komunës,

Neni V

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e kryetarit të komunës

Neni VI

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga kuvendi I komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Januar		13.05 2022	
Nj. Org	Numër	Shtesa	Vlera
01-	400/01-	21037	

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Gllogoc)

Zyra e Kryetarit



Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të Ligjit për vetëqeverisje Lokale nr.031/L-040 dhe Ligjit nr.04/L-111 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, dhe Rregulloren nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonal të ujit, neni 4,5 dhe 6 dhe Rregullores (QRK) Nr. 19/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr.02/2013 mbi kriteret e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit: Në bazë të nenit 72, pika 72.2 nënpika (h) e Statutit të Komunës së Gllogocit, i dt. 16.09.2008, Kryetari i Komunës së Gllogocit, nxjerr këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për nisjen e proceduarve për themelimin e ndërmarrjes publike lokale, (NPL) në Drenas

Neni I

Me këtë Propozim-Vendim Kërkojmë nga Kuvendi Komunal në Drenas, që të merr vendim për nisjen e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale në komunën e Drenasit duke u bazuar në ligjet ekzistuese të Republikës së Kosovës.

Komuna e Drenasit po bënë përpjekje që me kapacitete dhe mundësitë buxhetore të ofroj shërbime të mira për qytetarët, andaj për të ofruar shërbim dhe mirëmbajtje të hapësirave publike kërkojmë që propozimi vendimi të aprovohet nga kuvendi komunal në Drenas.

Komuna vetëm për mirëmbajtjen e hapësirave publike kontraktin operator ekonomik për këto shërbime:

- Mirëmbajtjen e Sheshit dhe Hapësirave publike në komunën e Drenasit;
- Larjen dhe Fshirjen e rrugëve gjatë sezonës së Verës; ,
- Mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonës së Dimrit;
- Largim të deponive ilegale
- Mirëmbajtje e deponive të mbeturinave inerte

Këto projekte duke përfshirë edhe menaxhimin e mbeturinave është e domosdoshme që të kenë mirëmbajtje dhe përkujdesje institucionale nga komuna e Drenasit përmes themelimit të ndërmarrjes publike lokale (NPL). Me themelimin e ndërmarrjes publike lokale synojmë që këto shërbime të jenë të menaxhuara në mënyrën më të mirë të mundshme nga komuna e Drenasit. Andaj kërkojmë nga asambleja që të aprovohet propozimi vendimi për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, për menaxhimin e hapësirave publike në Drenas.

Neni II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Neni III

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga kuvendi I komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.

Kryetari i Komunës
Ramiz Hladrovci




ARSYETIM

Qëllimi i themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në Drenas është që të menaxhohen dhe mirëmbahen hapësirat publike në komunën e Drenasit.

Duke pasur parasysh se komuna e Drenasit është ndër komunat e Republikës së Kosovës që vitet e fundit është duke bërë hapa të dallueshëm dhe përparimtar në kompletimin e infrastrukturës publike me rrugë të reja, ujësjellës dhe kanalizim, rregullimin e hapësirave publike, gjelbërimin e hapësirave publike të qytetit të cilat kërkojnë edhe mirëmbajtje dhe ruajtje të këtyre investimeve në dobi të qytetarëve.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
MUNICIPAL GLLOGOC
03 Nr. 400/1-22255
MB 19/05/2022



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E DRENASIT

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Drenas, më 19.05.2022

PËR : Menaxherët-Mbajtësit e Buxheteve komunale

NGA: Kushtrim Bajraktari, Zyrëtar Kryesor Financiar



LËNDA: QARKORJA INTERNE BUXHETORE KOMUNALE 2023/01-PËRGATITJA E PLANIFIKIMIT TË PRIORITETEVE PËR PERIUDHËN E DREJTORATEVE, ZYRËVE KOMUNAL, 2023-2025

1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj qarkoreje buxhetore është të njoftojë mbajtësit e buxheteve komunale rreth informatave që kërkohen dhe orarit kohor për kompletimin e procesit të planifikimit të prioriteteve nga drejtoratet-zyrërat komunale, për periudhën 2023-2025.

Në kuadër të qeverisjes lokale, buxheti përfshin një plan të përgjithshëm për arritjen e synimeve dhe objektivave sipas drejtorateve-zyrëve komunale (programe buxhetore). Procesi buxhetor ka të bëjë me ndarjen e resurseve për programet dhe shërbimet e caktuara, prandaj konsiderohet si një nga aktivitetet më të rëndësishme të institucionit qeverisës.

Një proces buxhetor i integruar mirë rezulton me vendime më të mira financiare duke ndikuar kështu pozitivisht në funksionimin e përgjithshëm të institucionit. Planifikimi i shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave, ka për synim arritjen e vlerës më të madhe për fondet e shpenzuara. Në këtë drejtim, përfshirja e zyrtarëve të ndryshëm -punonjësve të programeve buxhetore dhe të qytetarëve - publikut në përgjithësi, ndihmon në pasqyrimin e nevojave esenciale të hisedarëve në fushën e caktuar.

Aspekti teorik i buxhetimit paraqet planin financiar, i cili specifikon të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore, në këtë rast për periudhën 2023-2025. Me procesin buxhetor vlerësohen nevojat kundrejt mundësive në dispozicion.

2. Sfondi

Me procesin e ri buxhetor kërkohet që buxheti komunal të zhvillohet sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB-i Komunal). Qasja e KAB-it, kërkon që komuna të shqyrtojë më për së afërmi nevojat dhe të bëjnë caktimin e prioriteteve për alokimet buxhetore, për të siguruar pajtueshmërinë me objektivat e saj ekonomik, fiskale e sociale. Planifikimi i prioriteteve nga drejtoratet- zyrërat komunale, do t'u ofrojë mundësinë menaxherëve të programeve që të identifikojnë propozimet për shpenzime të prioritetit të lartë, bashkë me kursimet potenciale në programet e prioritetit të ulët, apo me performancë të dobët, para se të bëhet përcaktimi i kufijve final të buxhetit për secilin program. Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orjentuar drejt

rezultateve dhe performancës duhet të jenë synimi kryesorë. Gjatë muajve maj-qershor 2022, Drejtorati për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me drejtoratet tjera do të përgatit Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB-in), në të cilën theksohet prioriteti për buxhetin 2023-2025.

Këto prioritete janë:

- zhvilloi, promovoi dhe rigjeneroi infrastrukturën lokale,
- përmirësoi ambientin për të jetuar,
- përmirësoi sigurinë dhe shëndetsin e qytetarëve,
- zhvilloi sigurinë e shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit,
- ofroi mjete për nevojtarët, shërbime sociale dhe të dëmtuarit, dhe
- përkrah dhe zhvilloi biznesin dhe aftësitë individuale të talentëve, etj.

Drejtoratet-zyrë komonale duhet t'i shfrytëzojnë këto prioritete të larta si udhërrefyes në përgatitjen e rishikimit të proriteteve të tyre.

3. Shqyrtimi i prioritetëve të drejtorateve-zyrëve komonale

Nga të gjitha drejtoratet-zyrë, kërkohet të bëjnë planifikimin e programeve të tyre dhe prioritetëve të shfaqura në konteks të prioritetëve buxhetore të komunës (shih më lartë).

Ky planifikim i prioritetëve do t'u ofrojë mundësinë vendim-marrësve (Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa) që të bëjnë shqyrtimin e propozimeve të shkurtra nga menaxheret në një fazë të hershme dhe të identifikojnë ato propozime për të cilat do të kërkohet vlerësimi më i hollësishëm në dorëzimet e plota buxhetore. Si të tilla, vetëm informata të shkurtra dhe arsytme kërkohet gjatë planifikimit të prioritetëve.

Formati për kompletimin e planifikimit buxhetor (kërkesat buxhetore), është pjesë e kësajë qarkoreje.

Bazuar në Qarkoren Buxhetore Nr:2023/01 të lëshuar nga MFPT-ja, planifikimi i shpenzimeve buxhetore do të bëhet sipas metodës së Buxhetimit Programor. Metoda e B.P, kërkon që buxheti të planifikohet për nga funksioni i shpenzimeve në programe-nënprograme të përcaktuara me Statutin e Komunës, sipas skemës organizative të organizatës buxhetore; për nga klasifikimi ekonomik, shpenzimet do të planifikohen në 5 (pesë) kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve, në pajtim me rregullat financiare për shpenzimet (SIMFK) të nxjerra nga Thesari, si vijon:

1. Paga dhe Mëditje,
2. Mallra dhe Shërbime,
3. Shpenzime të Shërbimeve Komonale,
4. Subvencione-Transfer dhe
5. Shpenzime Kapitale.

Katër kategorit e para të shpenzimeve nifin si shpenzime rrjedhëse, të cilat me Q.B- të, të MFPT-së janë të limituara; për dallim nga kategoria e pestë që s'ka kufizime.

Maksimumi i rritjes së lejuashme të shpenzimeve të buxhetit operativ do të jetë i kufizuar deri në shkallën e rritjes reale prej 0.5%, krahasuar me buxhetin e vitit 2022. Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik, programet-nënprogramet buxhetore, duhet të planifikojnë

rritjen vjetore të faturës së pages në nivel prej 0.5%, sipas nenit 22C, pika 1.4 të Ligjit 05/L-063. Mjetet e planifikuara duhet të shpërndahen në mënyrë objektive nëpërmënkategoritë e mallrave dhe shërbimeve dhe do të mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Shpenzimet e Shërbimeve Komunale pritet të kenë pjesëmarrje të njëjtë në buxhet me vitin 2022. Subvencione-Transfere. planifikohet të kenë ulje mesatare prej 3.6% përgjatë periudhës 2023-2025.

Kompletimi i projekteve kapitale tanimë të filluara dhe/apo zotuar dhe atyre të-planifikuara nga viti paraprak. duhet të ketë prioritetin më të lartë për financimin e politikës së re. Përparësi për financim duhet të kenë projektet në vazhdim që janë inicuar në vitet paraprake dhe ato të cilat janë në harmoni të plotë me prioritetet e Komunës të aprovuara në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik nga Kuvendi i Komunës, e të cilat kanë deklaruar arsyeshmëri të plotë për financim. Duhet pas parasyshë se projektet e reja duhet të jenë në përputhje me: UDHËZIM ADMINISTRATIV MF - NR.04/2019 PËR DEFINIMIN E PROJEKTEVE KAPITALE DHE KLASIFIKIMIN E SHPENZIMEVE TË PROJEKTEVE KAPITALE dhe UDHËZIM ADMINISTRATIV MF- NR. 06/2019 PËR KRITERET PËRZGJEDHËSE DHE PRIORITETIZIMIN E PROJEKTEVE KAPITALE aprovuar nga MFPT-ja. Komuna duhet të tregojë se propozimet do të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë lokale, krijimin e vendeve të reja të punës, ngritjen e mirëqenjes së qytetarëve.

Nuk është e domosdoshme që programet, projektet apo kursimet e reja të fillojnë në vitin 2023, pasi që ky është një plan për periudhën 2023-2025, kursimi i propozuar apo projekti i ri mund të fillojë edhe më vonë.

Qëllimi i listës është të ndihmojë dhe të inkurajojë caktimin e prioriteteve dhe (ri-caktimin e tyre) për resurset buxhetore në programet që kanë si synim plotësimin e objektivave më të rëndësishme fiskale e sociale të Komunës.

Gjatë zhvillimit të buxhetit të propozuar nga drejtoratet-zyret, dhe kërkesave për ndarjen buxhetore për vitet 2023-2025, duhet të merret parasyshë Programi Qeveritar 2021-2025, struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike do të ketë fleksibilitet për planifikimin e shpenzimeve nga të hyrat vetanake komunale për vitin 2023, (duke përfshirë Pagat&Mëditjet).

Burimet e financimit për sektorë sipas Q.B-2023/01 të lëshuar nga MFPT, janë si vijonë:

Administrata: Granti i Qeverisë për vitin 2023 në shumën 7,829,315.00 €, të Hyrat Vetanake në shumën 1,297,468.00 €; për vitin 2024 Granti i Qeverisë në shumën 8,395,066.00 €, THV në shumën 1,348,786€; për vitin 2025: Granti në shumën 8,948,498.00 €,THV në shumën 1,404,054.00 €.

Arsim, Total Granti Specifik për vitin 2023 në shumën 6,538,735€, të Hyrat Vetanake në shumën 26,000.00 €; për vitin 2024: Granti në shumën 7,063,591.00 €, THV në shumën 26,000.00 €; për vitin 2025: Granti në shumën 7,095,276.00 €, THV në shumën 27,000.00 €.

Shëndetësia, Total Granti specifik për vitin 2023 në shumën 2,431,374.00 €, THV në shumën 34,000.00 €; për vitin 2024: Granti në shumën 2,552,943.00 €, THV në shumën 35,000.00 €; për vitin 2025: Granti në shumën 2,680,590.00 €, THV në shumën 36,000.00 €.

Gjithsej Buxheti Komunal :

-Viti 2023=18,156,892€.

-Viti 2024=19,421,386€.

-Viti 2025=20,191,418€.

4. Veprimi që kërkohet

1. Përgatitja e vlerësimeve të prioriteteve 2023-2025 për secilin program-nënprogram udhëhiqet nga secili drejtor i programit-nënprogramit, ku caqet e shpenzimeve përcaktohen për tri vite (2023-2025).

Planifikimi i bazuar në performancën e programit-nënprogramit është i obligueshëm. Programet buxhetore duhet të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave përkatëse në nivel të organizatës buxhetore, bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015) programet buxhetore janë përgjegjëse për „përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve” (Neni 5.1.5). Për këtë arsye, programet buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2023. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike.

2. Kompletimi i formularit, duke specifikuar prioritetet për periudhën 2023-2025,

3. Buxheti i programit duhet të bazohet në projekte konkrete për kategori të shpenzimit,

4. Kryetari i Komunës (ZKA) dhe ZKF-ja, mbajn takime konsultative me secilin drejtor të programeve buxhetore të komunës. Qëllimi i këtyre takimeve është të kuptohën arsyetimet për programet e reja / iniciativat rreth politikave si dhe kostos indikative,

5. Kompletimi dhe dorëzimi i kërkesave fillestare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa-Sektori i Buxhetit deri më: 31.05.2022, Forma-Formulari për plotësimin e kërkesave buxhetore do t'u shpërndahet programeve-nënprogrameve buxhetore menjëherë.

6. Fazat e përgatitjes së KAB-it 2023-2025:

-Fillimi i Qershorit Draft-KAB-i 2023-2025,

-Mesi i Qershorit konsultimet (Bordi i Drejtorve, Komiteti për Politikë dhe Financa, Qytetarët dhe Kuvendi i Komunës),

-Fundi i Qershorit publikimi i dokumentit të KAB-it.

7. 30 Qershori është afati i fundit për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB-it) në Kuvendin e Komunës, dhe dorëzimi në Ministrin e Financave.

Paraprkisht ju falenderojm për bashkpunim!

Me respekt,